



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 21/6 Prot.

Tiranë, më 10.05.2018

V E N D I M

Nr.42, datë 10.05.2018

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN PARALAJMËRUES NR.203, DATË 9.10.2017, TË KOMISIONERIT PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL, “PËR MIRATIMIN E RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË MBIKËQYRJES SË ADMINISTRIMIT TË SHËRBIMIT CIVIL NË NJËSINË E VETËQEVERISJES VENDORE, BASHKIA LEZHË DHE PARALAJMËRIMIN E INSTITUCIONIT PËR TË RREGULLUAR GJENDJEN E PALIGJSHMËRISË”

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1 dhe nenet 14 e 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në përfundim të procedurës së verifikimit,

VËREJ SE :

Me anën e kërkesës së regjistruar me nr. 21 prot., datë 15.1.2018, punonjësi ***** me detyrë “*Specialist Jurist*”, në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit, pranë Bashkisë Lezhë, ka kërkuar mendimin juridik të Komisionerit, nëse ai e gëzon statusin e nëpunësit civil në kushtet kur plotëson kriteret, por nuk ka një akt nga njësia e burimeve njerëzore të institucionit.

Punonjësi në fjalë pretendon se, në momentin që kanë filluar efektet juridike të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, ai ka qenë i punësuar në një pozicion pune të shërbimit civil për një periudhë më shumë se një vit, por nga ana e njësisë së burimeve njerëzore të institucionit, nuk ka dalë akt në lidhje me deklarin e statusit të tij si nëpunës civil. I ndodhur në këto kushte, punonjësi ***** i është drejtuar Komisionerit për Mbikëqyrjen e

Shërbimit Civil, duke kërkuar mendimin e tij nëse ai e gëzon statusin e nëpunësit civil dhe nëse duhet që t'i nënshtrohet procedurave të konkurrimit për pozicionin e punës ku punon aktualisht.

Duke u nisur nga sa më sipër, gjatë këtij hetimi administrativ, Komisioneri, administroi të dhëna nga Raporti Përfundimtar i Mbikëqyrjes të kryer pranë Bashkisë Lezhë, në muajin Tetor 2017, i cili ka përfunduar me vendimin paralajmërues nr. 203, datë 9.10.2017, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në njësinë e vetëqeverisjes vendore, Bashkia Lezhë dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e paligjshmërisë”*.

Rasti i punonjësit në fjalë, nisur nga aktet e administruara në dosjen e personelit, gjatë procesit të mbikëqyrjes, është trajtuar si emërim i përkohshëm, pas momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, në kundërshtim me këtë ligj. Konkretisht, nga përmbajtja e akteve të administruara në dosjen e këtij punonjësi, ka rezultuar se, ai ka filluar marrëdhënien e tij të punës në Bashkinë Lezhë me aktin nr.22, datë 13.1.2017, të Kryetarit të Bashkisë, nëpërmjet të cilit është emëruar në pozicionin *“Specialist Jurist”*, në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit (*detyrë të cilën e kryen aktualisht*).

Në këto kushte, në pikën 7, të vendimit paralajmërues të Komisionerit, në lidhje me emërimet në kundërshtim me ligjin, i është kërkuar Kryetarit të Bashkisë Lezhë, që:

- ✓ *të konstatojë menjëherë pavlefshmërinë absolute të akteve të emërimit dhe rregullimin e pasojave, duke ndërprerë marrëdhëniet financiare me institucionin për punonjësit e emëruar në kundërshtim me procedurën e përcaktuar në ligjin nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të cilët janë evidentuar sipas emrit, pozicionit të punës dhe aktit të emërimit (ku është përfshirë edhe punonjësi *****).*

Në vijim, i është lënë detyrë njësisë përgjegjëse, që të hartojë për vitin 2018, planin e punës së pranimeve në shërbimin civil, për zhvillimin e procedurave të konkurrimit, për pozicionet që do të mbeten të lira pas ekzekutimit të këtij vendimi, duke respektuar rregullat e përcaktuara në kreun IV, *“Pranimi në shërbimin civil”*, të ligjit nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, si dhe në aktet nënligjore.

Kjo situatë e konstatuar nga Komisioneri, në lidhje me gjendjen e administrimit të shërbimit civil në Bashkinë Lezhë, i është njoftuar paraprakisht institucionit të mbikëqyrur nëpërmjet Projektraportit të Mbikëqyrjes, dërguar me shkresën nr. 219/3, datë 28.7.2017, i cili, është kthyer i nënshkruar nga institucioni, nëpërmjet shkresës nr.6882/1 prot., datë 15.9.2017, pa observacion, duke qenë dakord me të gjitha gjetjet.

Ndërkohë, pasi i është njoftuar vendimi i Komisionerit punonjësit ***** , nëpërmjet kërkesës së tij, ai pretendon se, ka filluar punë në datën 1.9.2007, në pozicionin *“Jurist”*, në ish

Komunën Shëngjin, sot Njësi Administrative e Bashkisë Lezhë dhe ka zhvilluar karrierën pa ndërprerje në këtë institucion, ç'ka e bazon në aktet zyrtare që i citon në kërkesën e tij.

Në këto rrethana, me shkresën nr. 21/1 prot., datë 26.1.2018, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, “*Kërkohet dokumentacion në lidhje me punësimin e punonjësit ******”, drejtuar Kryetarit të Bashkisë Lezhë dhe për dijeni punonjësit *****, i është kërkuar njësisë së burimeve njerëzore të institucionit si dhe punonjësit në fjalë, që të dërgojnë një kopje të të gjitha akteve administrative që disponohen në lidhje me këtë rast.

Në përgjigje të kësaj shkrese, nga ana e institucionit, bashkëlidhur shkresës kthim përgjigje me nr.870/1 prot., datë 6.2.2018, të Kryetarit të Bashkisë Lezhë, protokolluar pranë Komisionerit me nr. 243 prot., datë 8.2.2018, janë dërguar kopje të akteve zyrtare që kanë lidhje me punësimin e punonjësit *****.

Nga këqyrja e këtyre akteve konstatohet se, punonjësi ***** ka filluar marrëdhënien e punës me aktin administrativ nr. 50, datë 1.9.2007, të kryetarit të Komunës Shëngjin, në pozicionin “*Jurist*” dhe më pas, me aktin nr.3/6, datë 3.1.2012, është emëruar “*Përgjegjës i Zyrës Juridike*” pranë kësaj komune. Sipas librezës së punës, bashkëlidhur këtyre akteve, konstatohet se, marrëdhënia e tij e punës ka vazhduar pa ndërprerje. Ky punonjës, rezulton të ketë qenë në këtë pozicion pune në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar (data 26.2.2014), i cili përfshin në fushën e veprimit të tij edhe komunat, si njësi të pavarura të qeverisjes vendore, e përcaktuar kjo në nenin 2, të këtij ligji, si dhe në pikën 2, të Vendimit nr.142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”, i ndryshuar. Nisur nga ky fakt, sektori i administrimit të burimeve njerëzore, pranë Komunës Shëngjin, i cili ka pasur funksionet e njësisë përgjegjëse për tu shprehur në lidhje me Aktin e Deklarimit të Statusit të Punësimit, për punonjësit që kanë qenë në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, përfshirë këtu edhe punonjësin ***** duhet të ishte shprehur në lidhje me këtë akt. Ndërkohë, gjatë procesit të mbikëqyrjes, nuk u vu në dispozicion të grupit të punës një akt i tillë.

Më tej, pas riorganizimit në organet e qeverisjes vendore të ndodhur në vitin 2015, shtrirja territoriale e Bashkisë Lezhë, ka përfshirë ndër të tjera edhe Njësinë Administrative Shëngjin (ish Komuna Shëngjin), parashikuar në ligjin nr.115/2014, “*Për ndarjen administrativo-territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë*”. Sipas nenit 65, të ligjit nr. 139/2015, “*Për vetëqeverisjen vendore*”, i cili rregullon funksionimin dhe organizimin e njësisve të vetëqeverisjes vendore, *struktura dhe organika e administratës së njësisve administrative janë pjesë të strukturës dhe organikës së administratës së bashkisë*. Nisur nga këto rregullime ligjore, është miratuar nga Kryetari i Bashkisë Lezhë, struktura dhe organika e administratës së bashkisë dhe njësisve administrative, me Vendimin nr. 296, datë 4.7.2016, “*Për miratimin e strukturës organike të bashkisë, të institucioneve vartëse, të agjensive, të njësisve administrative dhe të*

sektorëve që financohen nga buxheti i shtetit për vitin 2016”, e ndryshuar. Mbi bazën e kësaj strukture, e cila ka qenë në fuqi në momentin e realizimit të mbikëqyrjes, është konstatuar se, punonjësi *****, është emëruar në pozicionin “*Specialist Jurist*”, në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit, pranë Bashkisë Lezhë, me aktin nr. 22, datë 13.1.2017, të Kryetarit të Bashkisë. Gjatë procesit të mbikëqyrjes, në dosjen individuale të këtij punonjësi, është administruar vetëm ky akt dhe në këto rrethana, Komisioneri, e ka konsideruar emërimin e tij në kundërshtim me ligjin për nëpunësin civil.

Ndërkohë, aktet zyrtare të depozituara pranë Komisionerit nga ana e institucionit, pas kërkesës së punonjësit *****, siç janë aktet e emërimit, si dhe librezat e punës, provojnë zhvillimin e marrëdhënies së punës pa ndërprerje, që nga viti 2007, të punonjësit në fjalë. Nisur nga ky fakt, rezulton se, ky punonjës, në momentin që kanë filluar efektet juridike të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, kishte më shumë se një vit, që e kryente detyrën e tij funksionale në një pozicion pune pjesë e shërbimit civil.

Në këto kushte, bazuar në përcaktimet e pikës 3, të nenit 67, të ligjit, punonjësi ***** është *nëpunës civil* pavarësisht faktit se, njësia përgjegjëse, nuk e ka nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit. Mosveprimi i njësisë përgjegjëse në këtë rast, nuk e prek në thelb procesin e deklarimit të statusit të punësimit, pasi punonjësi në fjalë, formalisht nuk e ka këtë akt, por ai realisht e gëzon statusin e nëpunësit civil për shkak të ligjit dhe njësia përgjegjëse, është e detyruar të nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit.

Për këto arsye:

Bazuar në nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, në ligjin nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*” e nenin 35, të Rregullores, “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Ndryshimin e pikës 7, të Vendimit paralajmërues nr. 203, datë 9.10.2017, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me emërimet në kundërshtim me procedurën e përcaktuar në ligjin nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, në pjesën ku flitet për punonjësin *****, duke e shfuqizuar atë.
2. Shtimin në pikën 3, të Vendimit paralajmërues nr. 203, datë 9.10.2017, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ku ngarkohet njësia përgjegjëse, që, për të gjitha rastet e konstatuara, të nxjerrë aktet e deklarimit të statusit të punësimit në kategorinë “*nëpunës civil*”, duke e plotësuar këtë pikë si më poshtë:

- Njësia përgjegjëse e institucionit, në rastin e punonjësit *****, duke patur parasysh që, **a)**pozicioni i punës është pjesë e shërbimit civil; **b)**punonjësi ka më shumë se një vit, që e kryen detyrën funksionale në atë pozicion pune; si dhe **c)**plotëson kriterin e nivelit arsimor të diplomës së arsimit të lartë (*punonjësi disponon diplomë të arsimit të lartë si “Jurist”*), të nxjerrë aktin e deklaramit të statusit të punësimit në kategorinë “*nëpunës civil*”, në pozicionin “*Specialist Jurist*”, në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit, pranë Bashkisë Lezhë.
 - Në kushtet kur punonjësi ***** është nëpunës civil, pozicioni i punës “*Specialist Jurist*”, nuk konsiderohet vend i lirë dhe punonjësi në fjalë nuk i nënshtrohet procedurave të konkurrimit.
3. Njësia përgjegjëse të institucionit, i tërhiqet vëmendje, për mosveprimin në lidhje me deklaramin e statusit të punësimit për punonjës të *****, mosplotësimin e dosjes së personelit me të gjitha aktet që tregojnë zhvillimin e karrierës së nëpunësisë si në rastin konkret, si dhe mosvënien në dispozicion të Komisionerit të materialeve gjatë procesit të mbikëqyrjes.
 4. Të njoftohen për këtë vendim, Bashkia Lezhë dhe njësia e burimeve njerëzore të institucionit, si dhe nëpunësi *****.
 5. Për kryerjen e detyrave të përcaktuara më sipër, institucionit i lihet afat, **10** ditë.
 6. Me kalimin e këtij afati, duhet të njoftohet me shkrim Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mënyrën e zbatimit të vendimit.
 7. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për moszbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha